



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Nika Pro Ing shpk" të datës 02.03.2026 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i tribunës lindore te stadiumi 2 Korriku – faza e III-të" me nr. të prokurimit 616-25-7285-5-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET si pjesërisht e bazuar** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Nika Pro Ing shpk" të datës 02.03.2026 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i tribunës lindore te stadiumi 2 Korriku – faza e III-të" me nr. të prokurimit 616-25-7285-5-2-1 ashtu që **ANULOHE**T njoftimi mbi vendimin i autoritetit kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të dërgoj në **RIVLERËSIM** aktivitetin e prokurimit nga pika I e këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Nika Pro Ing shpk" (tutje "parashtruesi") me datë 02.03.2026 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i tribunës lindore te stadiumi 2 Korriku – faza e III-të" me nr. të prokurimit 616-25-7285-5-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

Pretendimi 1- OE i rekomanduar për kontratë nuk është i përgjegjshëm dhe duhet eliminuar automatikisht ngase nuk ka ofruar kontrata për punë të ngjashme

Argumenti ynë:

Autoriteti Kontraktues ka kërkuar që:

“Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të ngjashme për punë në vlerë minimale prej 300,000.00 € në tri (3) vitet e fundit, duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë.”

Ky kriter është i qartë, specifik dhe detyrues.

Nga dokumentacioni i dorëzuar rezulton se OE i rekomanduar ka paraqitur **kontrata furnizimi**, e jo kontrata për punë ndërtimore.

Nëse OE i rekomanduar nuk ka dëshmuar kontrata për punë në vlerën e kërkuar minimale prej 300,000.00 €, atëherë:

- Oferta e tij është e papërgjegjshme;
- Ai nuk i plotëson kriteret e kualifikimit profesional dhe teknik;
- Vendimi për rekomandim është në kundërshtim me Dosjen e Tenderit dhe legjislacionin në fuqi.

OE i rekomanduar ka paraqitur kontrata që përfshijnë furnizime, punime renovimi, gelqerosje, ngjyrosje, riparime etj.

Nuk ka kontrata për punë ndërtimore të objekteve që përputhen me llojin dhe vlerën e kontratës së procedurës aktuale.

Autoriteti Kontraktues nuk ka diskrecion të zëvendësojë kërkesën “punë” me “furnizim”, pasi kjo do të përbënte ndryshim material të kriterit

Konform Ligjit për Prokurim Publik ky OE duhet eliminuar.

Lista e kontratave të realizuara e dorëzuar nuk përmbush kërkesat minimale të vlerës së përcaktuar	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	69
--	---	----

OE i rekomanduar duhet të **eliminohet automatikisht nga procedura e tenderimit.**

Ky veprim është shkelje flagrante e parimeve të barazisë, transparencës dhe trajtimit të drejtë të operatorëve ekonomikë, të përcaktuara me nenin 7 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, si dhe bie ndesh me nenin 6 të të njëjtit ligj, që kërkon respektim të integritetit të procesit dhe vlerësim vetëm në bazë të kriterëve të dokumentuara.

Kjo mënyrë e vlerësimit kompromenton të gjithë procesin e Prokurimit Publik dhe krijon precedent të rrezikshëm për ligjshmërinë e procedurave

Kërkojmë që ky pretendim të merret seriozisht dhe të bëhet rishqyrtimi i vendimit në përputhje me dokumentacionin e dorëzuar, me parimet themelore të LPP-së dhe me praktikat/vendimet e OSHP-së.

Pretendimi 2 -OE i rekomanduar për kontratë nuk është i përgjegjshëm lidhur me autorizimet

Kërkesat e AK:

6. Autorizimin nga prodhuesi ose dileri (distributori i autorizuar) për pozicionet 2.2, 4.1, 5.1, 5.2, 5.4, 6.1, 7.2, 9.4

Argumenti ynë:

OE SELMANS NETWORK nuk ka përmbushur kriteret e qarta të AK-së, konkretisht:

Dosja ka kërkuar autorizime nga prodhuesi ose distributori i autorizuar për pozicionet 2.2, 4.1, 5.1, 5.2, 5.4, 6.1, 7.2 dhe 9.4;

OE SELMANS NETWORK ka dorëzuar disa autorizime, por ato nuk përputhen me kërkesat specifike të Autoritetit Kontraktues dhe kjo gjendje është në **kundërshtim të drejtpërdrejtë me Ligjin për Prokurimin Publik (LPP)**. Kjo tregon mospërmbushje të kriterit bazë të Dosjes së Tenderit dhe cenon vlerësimin e barabartë dhe korrekt të operatorëve.

Kjo është arsye e mjaftueshme për eliminimin e tij nga procedura, sipas parimeve të transparencës dhe trajtimit të barabartë të përcaktuara në LPP (Neni 7 dhe Neni 59-60).

OE i rekomanduar duhet të **eliminohet nga procedura e tenderimit.**

Kërkojmë që edhe ky pretendim të merret seriozisht dhe të bëhet rishqyrtimi i vendimit në përputhje me dokumentacionin e dorëzuar, me parimet themelore të LPP-së dhe me praktikat/vendimet e OSHP-së.

Pretendimi 3 - OE i rekomanduar për kontratë nuk është i përgjegjshëm lidhur me certifikatat CE dhe ENEC

Kërkesat e AK:

8- Operatori ekonomik duhet të ofrojë certifikata CE dhe ENEC për trupa ndriqes

Argumenti ynë:

Operator i rekomanduar ka dorëzuar disa certifikata, por asnjë nga këto certifikata nuk përmbushin kërkesat e Autoritetit Kontraktues.

Ai ka dorëzuar vetëm disa certifikata/katalogë të produktit, të cilat duket se janë marrë nga Google dhe nuk janë dokumente zyrtare që vërtetojnë përputhshmërinë me standardet CE/ENEC.

Dokumentacioni i dorëzuar nuk vërteton përputhshmërinë me standardet evropiane të sigurisë dhe cilësisë, të cilat janë të domosdoshme për produktet e ofruara.

Mungesa e certifikatave CE dhe ENEC për trupat ndriqes është një mosplotësim thelbësor i kërkesave të tenderit. Oferta nuk mund të konsiderohet e vlefshme dhe duhet të eliminohet nga procesi i vlerësimit.

OE i rekomanduar duhet të eliminohet automatikisht nga procedura e tenderimit.

Kërkojmë që edhe ky pretendim të merret seriozisht dhe të bëhet rishqyrtimi i vendimit në përputhje me dokumentacionin e dorëzuar, me parimet themelore të LPP-së dhe me praktikat/vendimet e OSHP-së.

Pretendimi 4— Eliminim i padrejtë për kompaninë tonë

Argumenti ynë:

Pas pranimit të kërkesës suaj për sqarime, ne kemi dorëzuar në tërësi dhe brenda afatit të përcaktuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar për plotësim, duke përmbushur kështu obligimet tona procedurale dhe ligjore në raport me këtë aktivitet prokurimi.

Përkundër kësaj, vendimi për eliminimin tonë është i pabazuar në fakte dhe në kundërshtim të drejtpërdrejtë me dokumentacionin e dorëzuar, duke paraqitur shkelje të parimeve themelore të procedurës së prokurimit publik, përkatësisht parimit të trajtimit të barabartë, proporcionalitetit dhe transparencës.

Eliminimi ynë në këto rrethana përbën tejkalim të kompetencës diskrecionale të Autoritetit Kontraktues dhe cenon rëndë sigurinë juridike të operatorëve ekonomikë. Një vendim i tillë, i marrë pa analizë të drejtë dhe të plotë të provave të dorëzuara, është arbitrar dhe juridikisht i paqëndrueshëm.

Për rrjedhojë, kërkojmë rishqyrtimin e menjëhershëm të këtij vendimi, duke e anuluar eliminimin tonë si të kundërligjshëm dhe në kundërshtim me parimet bazë të prokurimit publik.

Legjzton një fakt thelbësor dhe i pamohueshëm që jemi në përputhje të plotë me kërkesat e përcaktuara në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit.

Në këtë rast, nëse komisioni i vlerësimit ka bërë gabim, zyrtari përgjegjës i prokurimit është person kompetent që miraton ose refuzon rekomandimin, prandaj mban përgjegjësi të plotë për miratimin e një rekomandimi të paligjshëm. Pra, ne kemi plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit., dhe është fakt objektiv që as komisioni, as ZPP nuk mund ta anashkalojnë pa cenuar ligjin.

Si përfundim, duke qenë se kemi plotësuar të gjitha kërkesat dhe për më tepër, kemi dëshmuar kapacitet të mbi mjaftueshëm, vlerësojmë se vendimi për eliminimin tonë është i pabazuar dhe i pa-arsyetuar, duke na privuar padrejtësisht pasi jemi në përputhje të plotë me kërkesat e përcaktuara në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit.

Kërkojmë që edhe këto pretendime të merren seriozisht dhe të bëhet rishqyrtimi i vendimit në përputhje me dokumentacionin e dorëzuar dhe kërkesat e tenderit.

Si përfundim edhe për OE të rekomanduar:

OE SELMANS NETWORK është totalisht i papërgjegjshëm, pasi nuk ka përmbushur kërkesat e Autoritetit Kontraktues siç është cekur më lart, dhe ka manipuluar procedurën dhe ekziston dyshimi i arsyeshëm se ka bashkëpunuar me OE tjetër për të ndikuar rezultatin. Sjellja e tij është e paprueshme dhe duhet eliminuar automatikisht.

Vendimi për eliminimin tonë dhe shpalljen e tij fitues është arbitrar, disproporcionale dhe juridikisht i paqëndrueshëm.

Ju si Autoritet Kontraktues NUK e keni respektuar nenin 7 të LPP-së, duke na diskriminuar neve si Operator Ekonomik me çmimin më të lirë, dhe duke rekomanduar për kontratë OE të papërgjegjshëm më çmim më të lartë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do të trajtojë operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që Cjatat udhëheqjes së aktivitetëve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtësore të kushteve, kriterëve dhe specifikimeve përkatëse, mirëpo ju nuk i jeni përmbajtur as kësaj dispozite ligjore.

Po ashtu ju nuk e keni respektuar edhe nenin 6 të LPP-së edhe pse autoritetet kontraktuese janë të obliguar që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Sa i përket eliminimi të parashtruesit, sipas letrës standard arsytet eliminuese janë prezantuar si në vijim:

ARSYETIM

Ju jeni diskualifikuar për këto arsye :

Edhe pas sqarimeve të kërkuar nga AK nuk keni arritur të dëshmoni se i plotësoni të gjitha pikat e kërkesave në DT dhe NJK. Ju me ofertën tuaj si dhe me sqarimet e ofruara nuk keni mundur të dëshmoni se i plotësoni pikat e kërkesës nr. 6 për pozicionet 4.1, 7.2 dhe 9.4 si dhe pikën e kërkesës nr 8 për certifikatat e trupave ndriçuese CE dhe ENEC.

Sa i përket pretendimit lidhur me arsytet eliminuese, duhet sqaruar që komisioni vlerësues nuk ka specifikuar në mënyrë të saktë dhe precize arsytet për eliminim. Në konstatimin e komisionit thuhet që nuk është përmbushur kërkesa nr. 6 dhe kërkesa nr. 8 mirëpo nuk sqarohet pse nuk janë përmbushur këto kërkesa respektivisht cilat dokumente është dashur të dorëzohen sipas DT dhe nuk janë dorëzuar apo nëse janë kërkuar sqarimet shtesë cilat sqarime nuk janë ofruar nga OE në përputhje me DT. Prandaj me rastin e rivlerësimit komisioni duhet të administroj, krahasoj dhe ekzaminoj në mënyrë të saktë dhe precize arsytet eventuale për secilin nga OE ofertues nëse të njëjtit i përmbushin kushtet sipas nenit 59 par. 4 për eliminimin nga aktiviteti i prokurimit.

Sa i përket pretendimeve drejtuar kundër OE "Selmans Network" është gjetur se me rastin e vlerësimit të parë kur është shpallur fitues OE Hart Engineering, nuk është parashtruar fare kërkesë për rishqyrtim duke u pajtuar me të gjeturat dhe vendimin e AK. Prandaj në këtë fazë ky OE nuk mund të trajtohet si palë me interes në kuptim të nenit 4 par. 1 nënpar. 26 të LPP.

Sa i përket pretendimeve ankimore të tjera të drejtuara kundër tenderuesit të rekomanduar, komisioni për rivlerësim duhet të shqyrtoj këto pretendime një nga një me qëllim të vlerësimit të ofertave sërish nga fillimi në përputhje me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik dhe në përputhje të plotë me dosjen e tenderit.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pjesërisht pretendimet e tij ankimore. Prandaj kërkesa e tij për rishqyrtim është miratuar si e bazuar pjesërisht.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP.

Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 05.03.2026

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës



Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.